



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DECANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECAN



Drejtoria për Inspektion

Nr. 10 _____ /2025

Datë/Data	04.07.2025
Për/To/Za	Bashkim RAMOSAJ- kryetar i Komunës
Nga/from/Od	Ajne Iberhysaj- U.D Shefe Inspepcionit
Tema/Subject/Subjekat	RAPORT I PUNËS PËR PERIUDHEN JANAR-QERSHOR 2025

Drejtoria për Inspektion e gjata gjashtëmujorit të parë të vitit kalendarik 2025 kanë kryer punët dhe detyrat e punës të mbështetur në Ligjet, aktet nënligjorë, rregulloreve komunale me të cilat tregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përbajtur Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2025. Në Kuadër të drejtorisë për Inspektion janë sistemuar këta zyrtar:

Inspektorja e Tregut,

Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit që njëkohësisht është edhe shefe e inspektorëve

Inspektori i Ndërtimit (me Kontratë mbi shërbimet e Veçanta),

Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta) dhe

Inspektorët përkatës sipas fushave inspektuese të tyre kanë vepruar duke kryer inspektime (kontrolle mbikëqyrjeje) ndaj veprimtarive tregtare, ekonomike, ndërtimit, në fushën e mjedisit, afatizimin e prodhimeve bujqësore si nga produktet qumështit dhe me prejardhjen e tyre. Në ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit publik, në ushtrimin e veprimtarive sipas inspektorëve në pajtim me kërkesat në pajtueshmëri me legjislacionin e Republikës së Kosovës;

Drejtoria e Inspektionit ka kryer inspektime të përbashkët me: Stacionin e Policisë, Komisionin për Miniera dhe Minerale, me Inspektoratin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë e komunës ku këto inspektime kanë pasur për qëllim racionalizimin dhe koordinimin e veprimeve inspektuese të përbashkëta.

Gjithashtu inspektimet e planifikuara – janë inspektimet të realizuara sipas planit të punës dhe planit të monitorimit; Inspektimi i paplanifikuar ka përfshirë edhe procesin e inspektimeve i cili paraqitet ad-hoc dhe sipas nevojës pozitës zyrtare profesionale të inspektorit; po duke u bazuar edhe në kërkesat e parashtruara. Gjithashtu, janë kryer edhe inspektime sipas kërkesave të

NACIONALE DREJTORIA PËR INSPEKTON REPUBLIKËS SË KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DECANIT - DECAN MUNICIPALITY	
Nr. 10 _____ /2025	
Data: 04.07.2025	
Dokumenti nr. 16703	
02	04.07.25

Dr. Inspektorin 16703

personave fizikë dhe juridikë janë inspektimetë të realizuara në bazë të paraqitjes së kërkesave në Intranet;

Ri-inspektimi është inspektimi përcjellës që kryhet gjatë dhe pas kalimit të afatit të caktuar nga inspektori lidhur me përbushjen e urdhrit apo kërkesave për eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë inspektimit;

Këshilla inspektuese të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të legjislacionit në fuqi dhe eliminimit të të gjeturave subjekti inspektues si dhe marrjen e masave administrative dhe shqiptimit të gjobave që kanë për qëllim shmangjen e rreziqeve që mund t'i shkaktohen shëndetit publik, sigurisë publike, mjedisit dhe interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë, të përcaktuara nga ligjet apo me ligje të veçanta.

Janë marrë veprime për shkeljet serioze duke i veçuar ndërtimet në kundërshtim me ligjet ne fuqi dhe kushtet urbanistike të lëshuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, po ashtu edhe mbi ndërtime pa leje të ndërtimit duke inicuar edhe ngritjen e kallëzimeve penale.

Në kuadër të drejtorisë janë marrë masa administrative për lëshimin e fletëpagesave, taksave administrative, gjobave mandatorë përmes sistemit të Intranetit varësisht prej Ligjeve, Udhëzimeve Administrative dhe Rregullores Komunale në secilën fushë përkatëse të inspektimit. Duhet të theksohet edhe se janë kryer edhe punë tjera sipas fushe veprimtarisë të seilit nga inspektorët. Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve: **Tabela 1**

Pozita zyrtare	Inspekti me në teren sipas detyrës zyrtare	Inspektimet sipas kërkesë- personave fizik dhe juridik	Aktvendime	Gjoba mandatorë	Inspektimet për leje të ndërtimit	Inspektimet për leje mjedisore	Kërkesa për gjykatë
Inspektorja për mbrojtje të mjedisit	23						
Inspektori i tregut	21	84	12	6	8	8	0
Inspektori i ndërtimit	42						
Inspektori i Veterinarisë	13						
Gjithsej	99	84	12	6	8	8	0

Kërkesë: Si çështje e ndjeshme që është ndërtimi dhe cilësia e ushqimit (produkteve të qumështit dhe mishit) zgjidhja e çështja e inspektorëve të ndërtimit dhe veteranës është e domosdoshme.